



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar rre dt.	03.11.2020
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-270

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues

Prizren, më 03.11.2020

Prof. Asoc. Dr. Naser Bajraktari

Në mbështetje të nenit 23 paragrafi 1.6, nënparagrafi 1.6.2, të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores me nr. prot. 01-11/A të datës 18.01.2019, për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin "Ukshin Hoti", Prizren

Neni 1

Miratohet propozimi i Komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin "Ukshin Hoti".

Neni 2

Neni 9 i Rregullores ndryshohet dhe riformulohet si vijon :

1. Personeli akademik i emëruar apo i zgjedhur në njërin prej posteve udhëheqëse të përcaktuar si në paragrafin 2 të këtij neni, pagën bazë do ta marrë si profesor i rregullt .
2. Personelit akademik, i emëruar apo i zgjedhur në njërin prej posteve udhëheqëse të përcaktuar si më poshtë, në përputhje me këtë rregullore, i takon shtesa mujore mbi pagën bazë si në vijim:

Tabela 3.

Nr. rendor	Emërtimi i pozitës	Paga bazë	Shtesa
1	Anëtarët e Këshillit Drejtues të zgjedhur nga Senati	Profesor i rregullt	200.00 €
2	Rektor	Profesor i rregullt	600.00 €
3	Prorektor	Profesor i rregullt	450.00 €
4	Dekan i fakultetit	Profesor i rregullt	350.00 €
5	Prodekan i fakultetit	Profesor i rregullt	250.00 €

3. Personeli akademik i emëruar apo i zgjedhur në njërin prej posteve udhëheqëse të përcaktuar si në paragrafin 4 të këtij neni, pagën bazë do ta marrë në përputhje me thirrjen akademike që bart.
4. Personelit akademik, i emëruar apo i zgjedhur në njërin prej posteve udhëheqëse të përcaktuar si më poshtë, në përputhje me këtë rregullore, i takon shtesa mujore mbi pagën bazë si në vijim:

Tabela 3.1

Nr. rendor	Emërtimi i pozitës	Paga bazë	Shtesa
1	Profesor emeritus	Në bazë të thirrjes akademike	250.00 €
2	Këshilltar i rektorit	Në bazë të thirrjes akademike	200.00 €
3	Koordinator për shkencë dhe projekte	Në bazë të thirrjes akademike	200.00 €
4	Shef i departamentit (programit)	Në bazë të thirrjes akademike	100.00 €
5	Drejtor i Institutit	Në bazë të thirrjes akademike	120.00 €
6	Sekretar i institutit	Në bazë të thirrjes akademike	70.00 €
7	Trajnerët e qendrës profesionale dhe institutit për orë trajnimi	Në bazë të thirrjes akademike	25.00 €

Neni 3

Neni 12 i Rregullores ndryshohet dhe riformulohet si vijon :

1. Rektori i Universitetit nuk është i obliguar të mbajë ligjërata për realizimin e normës së paraparë, ndërsa mund t`i mbajë deri në 6 (gjashtë) orë në kuadër të mbi normës.
2. Prorektori, anëtari i Këshillit Drejtues i zgjedhur nga Senati dhe Dekani nuk janë të obliguar të mbajnë ligjërata për realizimin e normës së paraparë, ndërsa mund t`i mbajnë deri në 6 (gjashtë) orë në kuadër të mbi normës.
3. Prodekani, ka për obligim të mbajë 3 (tri) orë për realizimin e normës së paraparë, ndërsa mund t`i mbajë deri në 6 (gjashtë) orë në kuadër të mbi normës.

Neni 4

Neni 16 paragrafi 1 i Rregullores ndryshohet dhe riformulohet si vijon :

Tabela 7.

Nr. rendor	Emërtimi i komisionit	Kompensimi	
		Sistem 4 vjeçar	Sistem 3 vjeçar
1	Mentori	50.00 €	30.00 €
2	Anëtari (ët) e komisionit	20.00 €	20.00 €

Neni 5

Ky plotësim dhe ndryshim i Rregullores hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prof. Asoc. Dr. ~~Naser Bajraktari~~

Kryesues i Këshillit Drejtues

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Njësive Akadematike;
- Zyrës Ligjore;
- Zyrës së Personelit;
- Zyrës së Financave;
- Arkivit.

